



MJEKU, MJEKJA QË KRYEN NDËRPRERJEN E SHTATZËNISË KA NEVOJË PËR:

1. Çertifikatën e këshillimit të parashikuar me ligj
2. Kartën e sigurimeve, mundësisht me transfertën
3. Honorarin e mjekut kesh (informohuni gjatë regjistrimit) ose në rastin e të ardhurave të pakta çertifikata e mbulimit të shpenzimeve nga sigurimi (duhet marrë paraprakisht)
4. Analizën e grupit të gjakut, nëse është (p.sh kartelën e vjetër të nënës/çertifikatën e dhurimit të gjakut)

Informacione më të detajuara gjeni në broshurën e ndërprerjes së shtatzënisë së shoqatës federale pro familia:

www.profamilia.de

SHOQATA FEDERALE PRO FAMILIA NRW

Shoqata federale pro familia NRW e.V. është një organizatë jofitimprurëse e cila vepron në mbi 30 qendra këshillimi në zonën e Nordrhein-Westfalen. Ne ofrojmë konsulencë, informacione dhe organizojmë takime për:

- Seksin dhe çiftin
- Shtatzëninë dhe planifikimin familjar
- Edukimin dhe ndërgjegjësimin seksual

Informacionet për ato që ofron pro familia i gjeni në:

pro familia Landesverband NRW e.V.
Postfach 13 09 01 · 42036 Wuppertal
Telefon: 0202-245 65-0
E-Mail: lv.nordrhein-westfalen@profamilia.de

www.profamilia-nrw.de

QENDRA JUAJ E KËSHILLIMIT PRO FAMILIA



Informacion i shkurtër mjekësor për ndërprerjen e shtatzënisë

Landesverband
Nordrhein-Westfalen



Një shtatzëni mund të ndërpritet me medikamente ose në mënyrë operative. Të dyja këto metoda kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Parimisht asnjëra prej tyre nuk është më e mirë se tjetra, më e butë apo njësoj e përshtatshme për çdo grua. Më e rëndësishme është që çdo grua të vendosë vetë se cila nga këto metoda është më e përshtatshme për të.

NDËRPRERJE ME MEDIKAMENTE

Ndërprerja e shtatzënisë me medikamente është e mundur deri në fund të javës së nëntë të shtatzënisë (përkatësisht dita 63 e shtatzënisë, e llogaritur nga dita e parë e menstruacioneve të fundit).

Për këtë ju duhet të takoni mjekun disa herë. Pasi të keni biseduar me mjekun dhe pas një kontrolli paraprak ju do të merrni deri në tre tableta, të cilat do të ndërpresin shtatzëninë tuaj. Këto tableta mund të shkaktojnë gjakderdhje dhe në raste shumë të rralla edhe prishjen e shtatzënisë. Dy ditë më vonë ju do të merrni një medikament tjetër (tabletë ose ovul vaginal). Ky medikament shkakton gjakderdhje me anë të së cilës del edhe embrioni i shtatzënisë (e krahasueshme me një abort të parakohshëm). Në shumicën e klinikave gratë qëndrojnë nën vëzhgim për gati 3-4 orë pas marrjes së medikamentit të dytë. Në shumicën e rasteve ky medikament e jep efektin e tij brenda këtij harku kohor, në raste të rralla ai fillon të veprojë pas 24 orësh pas marrjes së medikamentit. Ai mund të shkaktojë dhimbje të forta të fundit të barkut (dhimbje të njëjta me ato të menstruacioneve, kur këto shoqërohen me dhimbje të forta) si dhe probleme me sistemin e qarkullimit të gjakut. Në rast nevojë ju mund të merrni edhe tableta kundër dhimbjeve. Nga eksperiencat e kaluara 20 nga 100 gra marrin tableta kundër dhimbjeve. Gjakderdhja zgjat nga 7 deri në 12 ditë, në disa raste edhe më gjatë. Zakonisht ajo është më e fortë se gjakderdhja e menstruacioneve. Pas 14 ditësh duhet bërë një kontroll për tu siguruar nëse shtatzënia është ndërprerë plotësisht apo jo. Në raste të rralla ndodh të mos jetë ndërprerë plotësisht ose të mos

jetë ndërprerë fare. Në raste të tilla nevojitet marrja e një medikamenti tjetër ose një ndërhyrje operative.

Komplikime të tilla si infeksione, gjakderdhje shumë të forta apo gjakderdhje që kanë nevojë për trajtim mjekësor mund të ndodhin në raste shumë të rralla. Këto medikamente mund të shkaktojnë të përziera, diarre dhe të vjella.

NDËRPRERJE NË MËNYRË OPERATIVE

Përgjithësisht ndërprerja kryhet me metoda thithëse (aspirim me vakum). Ndonjëherë kryhet edhe një kruajtje (kyretim). Kjo ndërhyrje kryhet kryesisht me narkozë të plotë, në raste të rralla edhe me anestezi lokale. Në rastin e narkozës së plotë, një anestezist ju injekton në venat e krahut një narkozë, e cili ka efekt të shpejtë kështu ju do të jeni në gjumë gjatë ndërhyrjes. Më pas qafa e mitrës hapet me kujdes me anë të disa shufrave metalike. Shpesh ju merrni në avancë një medikament i cili zbut qafën e mitrës. Në fund përmes qafës së mitrës futet në mitër një tub i hollë plastik i cili është i lidhur me pajisjen thithëse. Në këtë mënyrë thithet një pjesë e mukozës dhe embrioni i shtatzënisë. Kjo ndërhyrje zgjat rreth 10 minuta. Gjakderdhja dhe dhimbjet e fundit të barkut janë normale pas një ndërhyrje të tillë, por nuk janë shenja që shfaqen tek të gjitha gratë.

Përgjithësisht ndërprerja operative kryhet në mënyrë ambulante. Pas 1-2 orësh ju mund të ktheheni përsëri në shtëpi, por gjithsesi ju nuk mund të udhëtoni vetëm. Nëse është e mundur merrni dikë t'ju shoqërojë ose t'ju marrë.

Në këtë rast rekomandohet një kontroll pas rreth 7-10 ditë.

Vetëm te pak gra ndodh të ketë komplikime gjatë ose pas ndërprerjes së shtatzënisë në mënyrë operative. Në raste shumë të rralla ndodh që shtatzënia të mos jetë ndërprerë plotësisht. Diçka e tillë do të bënte të domosdoshme një ndërhyrje tjetër operative për të zbrazur mitrën. Shumë rrallë mund të ketë dëm-

time në mitër. Në këto raste ajo shërohet pa pasoja. Gjithashtu mund të shoqërohet me gjakderdhje të forta ose me infeksione, të cilat përgjithësisht arrijnë të kurohen mirë. Në rast se ju keni gjakderdhje të forta, dhimbje, temperaturë mbi 38.5° C ose sekrecione me erë të keqe, atëherë ju duhet të kontaktoni mjekun ose mjeken tuaj. Në rast se një infeksion nuk kurohet shpejt dhe plotësisht, atëherë tubat e vezorëve mund të ngjiten dhe të ndikojnë më vonë në fertilitetin e gruas. Për të shmangur raste të tilla disa mjekë japin antibiotik.

Komplikimet nga anestezia lokale ose nga narkoza janë shumë të rralla.

PAS PËRDORIMIT

Kujdesuni për veten tuaj pas ndërprerjes së një shtatzënie, pavarësisht nga metoda që keni përdorur për ta realizuar atë. Në këtë mënyrë ju do të shmangni rrezikun e ndonjë komplikimi të mundshëm. Shumë mjekë rekomandojnë që në ditët e para pas ndërprerjes së shtatzënisë të mos futet asgjë në vaginë, në mënyrë që të shmangni ndonjë infeksion të mundshëm. Nëse doni të keni kujdes, mos përdorni tamponë por peceta higjienike, hiqni dorë nga marrëdhëniet seksuale, larja në vaskë dhe noti. Dushi dhe larja nuk përbëjnë problem.

Në ditën e ndërprerjes së shtatzënisë fillon menjëherë një cikël i ri dhe ju jeni sërish pjellore. Flisni në kohë ose më mirë në avancë me mjekun ose mjeken tuaj për mënyrat e mbrojtjes. Mbrojtja me pilula hormonale (p.sh kontraceptivë) mund të fillojë menjëherë që në ditën e ndërprerjes së shtatzënisë.

Çlirimi dhe pikëllimi janë ndjenja normale pas një procesi të tillë. Komplikimet mendore janë raste shumë të rralla. Bisedat me konsultorë janë shumë të dobishme në raste të tilla. Në qendrat e këshillimit pro familia keni mundësi për të kryer biseda të tilla.